VENDIM
Nr.868, datë 12.6.2009

PËR DHËNIE LICENCE
PËR PLATFORMËN PRIVATE NUMERIKE SATELITORE "TRING TV"
SUBJEKTIT "TRING TV" SHA

Në mbështetje të ligjit nr.9742, datë 28.5.2007 "Për transmetimet numerike në Republikën e Shqipërisë" dhe rregullores "Për licencimin e operatorëve të rrjeteve numerike tokësore e satelitore dhe të operatorëve për programet radiotelevizive", Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T'i japë subjektit "TRING TV" sh.a., licencë, duke e autorizuar të funksionojë si platformë private numerike satelitore, me afat 10-vjeçar nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZV/KRYETARI
Alban Karapici